



**UNIVERSITETI I MITROVICËS**  
**UNIVERSITY OF MITROVICA**  
**"ISA BOLETINI"**

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës  
http://www.umib.net; Tel: +381-28535725/535727

Kryesues i Këshillit Drejtues  
Dr. sc. Sabri Sadiku

Nr. Prot. 325/005  
Dt 09-03-2017

Në bazë të nenit 23, paragrafi 1.6, alinea 1.6.2 e Statutit të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", në koordinim me Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Administratës Publike, Këshilli Drejtues i Universitetit të Mitrovicës, në mbledhjen e mbajtur më 09. 03. 2017, miratoi:

**RREGULLOREN**  
*për unifikimin e të ardhurave personale të personelit administrativ në Universitetin e Mitrovicës "Isa Boletini"*

**I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

Mjetet për të ardhurat personale shfrytëzohen nga fondi i Buxhetit të Kosovës, nga tarifat e shkollimit dhe pagesat tjera të cilat i bëjnë studentët, nga pagesat dhe për shërbime komerciale dhe shërbime tjera dhe donacionet, dhuratat dhe ndihma tjera si dhe nga kontratat me organizma kombëtarë, ndërkombëtar publik dhe privat. Nga këto burime financiare paguhen të ardhurat personale dhe kompensimet tjera për personelin akademik dhe jo akademik në marrëdhënie të rregullt pune, si dhe puna mbi normë dhe puna me honorar për personelin akademik të rregullt dhe të angazhuar në Universitetin e Mitrovicës "Isa Boletini" (në tekstin e mëtejme: Universitetit).

**II. DISPOZITAT E VEÇANTA**

**Neni 2**

Personeli i administratës së Universitetit të Mitrovicës i nënshtrohet Ligjit për Shërbimin Civil të Kosovës, legjislacionit përkatës në fuqi, Statutit të Universitetit dhe akteve tjera të brendshme.

**Neni 3**

Shërbimi për financa i Universitetit bën përlllogaritjen e të ardhurave personale dhe pagesave tjera të përcaktuara në bazë të kësaj rregulloreje, ligjeve dhe akteve tjera nënligjore në fuqi, si dhe në bazë të vendimeve të veçanta të nxjerra nga organet kompetente të UMIB-it.

**Neni 4**

**PAGESAT PËR PERSONELIN E ADMINISTRATËS SË UMIB-it**

Nr	Përshkrimi i vendit të punës	Nr. i kryesve aktualë	Shtesa e caktuar me vendim të veçantë të Qeverisë	Paga bruto pa shtesë të qeverisë
1.	Sekretari i Përgjithshëm	1		1,428.75
2.	Drejtor i Auditimit të Brendshëm	0		1,126.13
3.	Drejtori i Departamentit	2		858.75
4.	Drejtor – Udhëheqës i Zyrës – Njësisë	5		768.75
5.	Drejtor – Udhëheqës i Zyrës – Njësisë i TI – së	1	Sipas vendimit të MAP në bazë të vendimit të Qeverisë	768.75
6.	Sekretar i Fakultetit	2		768.75
7.	Zyrtar i auditimit të brendshëm	0		872.30
8.	Zyrtar llojor	0		500.00

9.	Certifikues	0		500.00
10.	Asistent administrativ	0		471.25
11.	Asistent në zyrën e rektorit	1		471.25
12.	Vozitës	2		414.00
13.	Zyrtar i personelit	1		500.00
14.	Zyrtar për barazi gjinore	0		500.00
15.	Zyrtarë në zyrën për çështje akademike	0		500.00
16.	Zyrtar për arkiv në AQ	1		471.25
17.	Zyrtar për protokollim në AQ	0		471.25
18.	Zyrtar për redaktim dhe lekturë	1		500.00
19.	Zyrtar për logjistikë	0		500.00
20.	Depoist në AQ	0		414.00
21.	Receptionist	0		385.50
22.	Punëtor në bufe	1		385.50
23.	Zyrtar i rrjetit	1	400	500.00
24.	Zyrtarë në Zyrën e TI – së	0	Sipas vendimit të MAP në bazë të vendimit të Qeverisë	500.00
25.	Zyrtar për informim dhe protokoll	0		500.00
26.	Zyrtar për mirëmbajtjen e web faqes	0		500.00
27.	Zyrtar për çështje të studentëve	0		471.25
28.	Zyrtar i lartë për buxhet dhe financa	0		500.00
29.	Zyrtar për paga dhe mëditje	0		500.00
30.	Zyrtar i të hyrave financiare	1		500.00
31.	Zyrtar i pasurisë	1		500.00
32.	Zyrtar për zotimin e mjeteve buxhetore	0		500.00
33.	Zyrtar për shpenzime	0		500.00
34.	Arkëtar	1		500.00
35.	Zyrtar i prokurimit	0		500.00
36.	Zyrtarë në ZMJ	0		500.00
37.	Zyrtarë në zyrën për zhvillim akademik, shkencë dhe cilësi	1		500.00
38.	Zyrtar i lartë për financa në Fakultet	1		500.00
39.	Zyrtarë i shërbimit të studentëve	5		442.50
40.	Zyrtar për logjistikë dhe asete në fakultete	2		442.50
41.	Zyrtar për TI në fakultete	0	Sipas vendimit të MAP në bazë të vendimit të Qeverisë	442.50
42.	Zyrtar për mësim	2		500.00
43.	Asistent-e në dekanat	3		442.50
44.	Zyrtar për Arkiv, protokoll dhe fotokopje	2		442.50
45.	Bibliotekar	1		442.50
46.	Laborant	7		471.25
47.	Zyrtar Teknik Administrativ – Nxehje Qendrore	1		385.50
48.	Zyrtar Teknik Administrativ	1		385.50

## DISPOZITAT KALIMTARE

### Neni 5

5.1. Pagat për nëpunësit e administratës së Universitetit të Mitrovicës, të caktuara me këtë rregullore, do të zbatohen deri në miratimin e Ligjit të pagave për të gjithë nëpunësit civil në nivel të Republikës së Kosovës. Nivelimi dhe harmonizimi i pagave për nëpunësit civil do të bëhet mbi bazën e klasifikimit të pozitave dhe gradave të pagës në shërbimin civil, të cilat do të përcaktohen dhe miratohen nga Ministria përgjegjëse për Administratë Publike.

5.2. Universiteti i Mitrovicës mund të caktojë shtesa mbi pagën bazë, pas aprovimit nga Ministria përgjegjëse për Administratë Publike.

5.3. Për të gjitha pozitat të cilat nuk janë të përfshira në këtë rregullore, ndërsa janë parapara në rregulloren për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës, do

të zbatohet lartësia e pagës bazë ekuivalente me pozitën e kategorisë së njëjtë apo të ngjashme deri në harmonizimin e pagave për të gjithë nëpunësit civil në nivel të Republikës së Kosovës.

5.4. Pagat e përcaktuara në nenin 4 të kësaj rregulloreje janë pjesë e shkrirjes së shtesës stimulative dhe pagës bazë ekzistuese, e cila është bërë në marrëveshje ndërmjet UMIB-it, MAP-it dhe MF-së.

5.5. Nëpunësit civilë, paga bazë e të cilëve pas zbatimit të Ligjit për pagat e shërbyesve civilë është më e vogël se paga bazë e tyre ekzistuese para hyrjes në fuqi të këtij ligji, ruajnë pagën e tyre ekzistuese bazë deri në kohën kur paga e tyre bazë të jetë në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe me dispozitat që kanë të bëjnë me klasifikimin e përgjithshëm të pozicioneve të punës në Shërbimin Civil, si dhe me standardet dhe procedurat për klasifikimin e secilës pozitë në gradën përkatëse.

### **Neni 6**

Kjo rregullore hyn në fuqi pas aprovimit nga Ministria Administratës Publike në bashkëpunim me Ministrinë për Financa.

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet neni 6 i Rregullores nr. prot. 1467 e datës 06.11.2015, mbi bazën e së cilës është bërë kompensimi i të ardhurave personale për nëpunësit e administratës së Universitetit.



Prof. asoc. dr. Sabri Sadiku

Kryesues i KD-së



**UNIVERSITETI I MITROVICËS**  
**UNIVERSITY OF MITROVICA**  
**"ISA BOLETINI"**

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës  
Http://www.umib.net; Tel: +381-28535725/535727

Kryesues i KD-së  
Dr. sc. Sabri Sadiku

Nr. Prot. 187/005  
Datë 13.02.2018

Në mbështetje të nenit 23 paragrafi 1.6, alineja 1.6.2 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit, Këshilli Drejtues i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", në mbledhjen e mbajtur më 8.2.2018, mori:

**VENDIM**

**Për Ndryshime dhe plotësime në  
RREGULLOREN**

**për unifikimin e të ardhurave personale të personelit administrativ në Universitetin  
e Mitrovicës "Isa Boletini", nr. prot. 325/005, dt. 09.03.2017**

**Neni 1**

Në nenin 4 "PAGESAT PËR PERSONELIN E ADMINISTRATËS SË UMIB-it" fshihet pika 3 e tabelës.

**Neni 2**

Në nenin 4 "PAGESAT PËR PERSONELIN E ADMINISTRATËS SË UMIB-it", pika 4 e tabelës ndryshon numri i kryesve aktualë, si më poshtë:

Nr	Përshkrimi i vendit të punës	Nr. i kryesve aktualë	Shtesa e caktuar me vendim të veçantë të Qeverisë	Paga bruto pa shtesë të qeverisë
4.	Drejtor – Udhëheqës i Zyrës – Njësisë	7		768.75

**Neni 3.**

Ndryshimet dhe plotësimet në Rregulloren për unifikimin e të ardhurave personale të personelit administrativ në Universitetin e Mitrovicës "Isa Boletini", nr. prot. 325/005, dt. 09.03.2017, hyjnë në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli i Përkohshëm Drejtues i Universitetit.

Mitrovicë,  
dt. 8.2.2018



Dr. sc. Sabri Sadiku  
Kryesues i Këshillit Drejtues



**UNIVERSITETI I MITROVICËS**  
**UNIVERSITY OF MITROVICA**  
**"ISA BOLETINI"**

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës  
Http://www.umib.net; Tel: +381-28535725/535727

Kryesues i KD-së  
Dr. sc. Sabri Sadiku

Nr. Prot. 1284  
Datë 27.09.2018

Në mbështetje të nenit 23 paragrafi 1.6, alineja 1.6.2 të Statutit të Përkohshëm të Universiteti, Këshilli Drejtues i Universiteti të Mitrovicës "Isa Boletini", në mbledhjen e mbajtur më 17.9.2018, mori:

**VENDIM**

**Për Ndryshime dhe plotësime në  
RREGULLOREN**

**për unifikimin e të ardhurave personale të personelit administrativ në Universitetin  
e Mitrovicës "Isa Boletini", nr. prot. 325/005, dt. 09.03.2017**

**Neni 1**

Në nenin 4 "PAGESAT PËR PERSONELIN E ADMINISTRATËS SË UMIB-it" pas pozitës me nr. rendor 47 shtohet edhe një pozitë: Zyrtar për infrastrukturë dhe menaxhim të objekteve me pagë bruto 500.00 euro, si në vijim:

Nr	Përshkrimi i vendit të punës	Nr. i kryesve aktualë	Shtesa e caktuar me vendim të veçantë të Qeverisë	Paga bruto pa shtesë të qeverisë
47.	Zyrtar për infrastrukturë dhe menaxhim të objekteve	0		500.00

**Neni 2.**

Ndryshimet dhe plotësimet në Rregulloren për unifikimin e të ardhurave personale të personelit administrativ në Universitetin e Mitrovicës "Isa Boletini", nr. prot. 325/005, dt. 09.03.2017, hyjnë në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Drejtues i Universitetit.

Mitrovicë,  
Shtator, 2018

Dr. sc. Sabri Sadiku

Kryesues i Këshillit Drejtues

